



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SE APELIT
KORÇË

RAPORT
MBI VEPRIMTARINË E PROKURORISË SË APELIT KORÇË
PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2019 - 31 DHJETOR 2019

Z. OLSIAN ÇELA
PROKUROR I PËRGJITHSHËM I REPUBLIKËS

PROKURORIA E PËRGJITHSHME
TI RANË

Në realizim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 të ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashtroj para Prokurorit të Përgjithshëm raportin vjetor të analizës së treguesve të punës mbi bazën e të dhënave statistikore, të angazhimeve dhe problematikave të konstatuara për vitin 2019.

Veprimtaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, për vitin 2019 si objekt analize, është ushtruar në vazhdimësi për zbatimin me korrektësi të Ligjit Procedural dhe Material Penal, Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në respektim të Kushtetutës së R.SH dhe Konventave Ndërkombëtare, duke treguar angazhim dhe përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me përfaqesimin e akuzës gjatë gjykimit në shkallë të dytë (në apel), veçanërisht për veprat penale kundër korrupsionit apo abuzimit me detyrën nga zyrtarët shtetërorë, krimet të organizuar dhe veprave penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, si dhe në procedimin penal ndaj të miturve, për respektimin dhe garantimin e të drejtave procedurale të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktima të veprës penale.

Gjatë këtij viti, duke mbajtur në konsideratë maksimale zbatimin e Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave “Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2019”, zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së datës 20.06.2019”, kemi synuar në mënyrë të vazhdueshme rritjen e standarteve të gjykimit me një përfaqësim cilësor dhe korrekt të prokurorit të apelit.

Në këtë kontekst, kërkimet e prokurorëve në apel janë në koherencë me zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe kjo materializohet më së miri në qëndrimet për ashpërsimin e politikës penale lidhur me masat e sigurimit dhe dënimet për krime të rënda, si dhe zbatimin e dënimeve alternative për vepra penale dhe autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore, për gratë dhe të miturit në konflikt me ligjin.

Për vetë specifikën e ushtrimit të funksionit të prokurorit të Apelit, si prokurori gjyqësore, veprimtari kjo që lidhet me një hetim paraprak të kryer nga Prokuroria

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm, por dhe me një gjykim dhe vendim të Gjykatës, qëndrimet e prokurorëve në apel për çështjet e gjykuara, në raport me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe vendimin e Gjykatës së Apelit, kanë krijuar një standart në luftën kundër kriminalitetit, i cili gjen pasqyrim tek të dhënat statistikore për vitin 2019.

Në analizën më poshtë, do të përqëndrohemi në probleme të rëndësishme që lidhen jo vetëm me qëndrimin e prokurorit të Apelit në raport me kërkimet e bëra nga prokurorët e shkallës së parë dhe qëndrimin e gjykatës, si edhe problemet e hetimit dhe gjykimin që janë evidentuar gjatë këtij viti me qëllim përmirësimin e mëtejshëm.

Në vazhdim të këtij raportimi, fillimisht do të japim një paraqitje të volumit të çështjeve të perfaqesuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, për vitin 2019 dhe më pas disa probleme që kanë dalë gjatë gjykimin dhe shqyrtimit të çështjeve.

- **Volumi i çështjeve në tërësi të ndjekura nga Prokuroria e Apelit Korçë është si më poshtë :**

Për vitin 2019, në Prokurorinë e Apelit Korçë janë regjistruar në total **426** çështje nga të cilat **390** çështje të reja dhe **36** të mbartura nga viti 2018.

Çështjet e gjykuara dhe të përfunduara për vitin 2019 janë gjithsej **385** çështje penale me pjesëmarrjen e prokurorit të Apelit nga të cilat:

-**146** çështje themeli,

-**128** masa sigurimi,

-**111** çështje të veçanta (*me objekt ankim vendim mosfillimi, me viktimë akuzuese, në seancën paraprake, në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, lirim me kusht, etj*).

-Janë mbartur për vitin 2020, **41** çështje (**19** janë çështje themeli, dhe 22 çështje të veçanta).

Duke krahasuar numrin e përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në vitin 2019 (**385 çështje**), me vitin 2018 (*ku numri i përgjithshëm i çështjeve të përfunduara ka qënë 545*), rezulton se ka një ulje të ndjeshme prej 120 çështjesh.

- **Volumi i çështjeve të ndara sipas prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, që janë në juridiksionin e Prokurorisë së Apelit Korçë:**

-Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë janë shqyrtuar 109 çështje themeli nga të cilat 11 çështje mbi apelin e prokurorit dhe 114 raste mbi apelin e të pandehurit, si dhe janë shqyrtuar 89 çështje me objekt masa sigurimi personal, nga të cilat 1 mbi apelin e prokurorit.

-Për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec janë shqyrtuar 37 çështje themeli nga të cilat, 11 raste mbi apelin e prokurorit dhe 38 raste mbi apelin e të pandehurit, si dhe janë shqyrtuar 39 çështje me objekt masa sigurimi personal, nga të cilat 5 mbi apelin e prokurorit.

-Në të dhënat statistikore nuk përfshihen 111 çështje të përfunduara, të cilat në kategorizojmë të veçanta, pasi kjo kategori nuk është e parashikuar në formularët e miratuar. Këto lloj çështjesh zënë një përqindje të konsiderueshme në veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë dhe që shpesh lidhen me problematikë delikate, siç janë ankimet në lidhje me vendimet e mosfillimit të procedimit penal, në fazën e ekzekutimit të vendimit penal, çështjet me akuzë private nga viktima akuzuese, çështjet të seancës paraprake etj, të cilat shqyrtohen mbi apelin e palëve në proces.

Ngarkesa e çështjeve për prokurorët e apelit :

- **Prokurore Rozeta Qirjaqi** ka përfaqësuar akuzën në apel në **250** çështje nga të cilat :

- 88** çështje themeli të përfunduar (*ka ushtruar rekurs në 17 raste*),
- 73** çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar (*ka ushtruar rekurs në 11 raste*),
- 72** çështje të tjera të kategorizuara të veçanta të përfunduar (*ka ushtruar rekurs në 2 raste*),
- 17** çështje të mbartura për vitin 2020 (*nga këto 9 çështje themeli dhe 8 çështje të veçanta*).

-Ka nxjerrë **28** urdhëra ekzekutimi për vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit, Po kështu që nga data 22.02.2019 ka ndjekur veprimtarinë e prokurorisë me cilësinë e drejtueses, bazuar në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- **Prokurore Irena Çunoti** ka ushtruar funksionin e prokurores në apel prej datës 22.02.2019 dhe ka përfaqësuar akuzën në **163** çështje nga të cilat :

- **51** çështje themeli të përfunduar (*ka ushtruar rekurs në 5 raste*),
- **53** çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar (*ka ushtruar rekurs në 2 raste*),
- 35** çështje të tjera të kategorizuara të veçanta (*ka ushtruar rekurs në 3 raste*).
- 24** çështje të mbartura për vitin 2020 (*nga këto 10 çështje themeli dhe 14 çështje të veçanta*).

-Ka nxjerrë **28** urdhëra ekzekutimi për vendimet gjyqësore të Gjykatës së Apelit.

- **Prokurore Irma Balli** ka ushtruar funksionin deri në datë 19.02.2019 dhe ka përfaqësuar akuzën në **13** çështje nga të cilat:

- **7** çështje themeli të përfunduar,
- **2** çështje me objekt masa sigurimi të përfunduar,
- **4** çështje të tjera të kategorizuara të veçanta të përfunduar,

-Po kështu, deri në datë 19.02.2019 ka ndjekur veprimtarinë e prokurorisë me cilësinë e drejtueses.

Më poshtë, po japim një analizë më të hollësishme të shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm, shkaqet e apeliemeve të bëra, përkrahjes së tyre dhe mënyrës së përfundimit.

I. ANALIZA MBI TREGUESIT STATISTIKORË PËR ÇËSHTJET E THEMELIT:

Për çështjet e themelit të shqyrtuara gjatë vitit 2019 është përfaqësuar akuza në Gjykatën e Apelit Korçë në **146** çështje, me 191 të pandehur, nga të cilët 87 të arrestuar.

-Në **17** çështje, për të cilat është kërkuar **mospranim ankimi**, nga gjykata është vendosur në 17 raste mospranim ankimi (*në këto raste çështjet janë apeluar nga të pandehurit dhe është disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë prej tyre nga ankimi në seancë gjyqësore, në kushtet kur ankimi ka ngelur pa objekt, apo nuk janë respektuar dispozitat për formën dhe afatin e ankimit*).

-Në **102** raste, për të cilat prokurori i apelit ka kërkuar **lënie në fuqi** të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga Gjykata e Apelit është disponuar : në 73 raste për lënie në fuqi; në 22 raste është lehtësuar pozita e të pandehurit; në 5 raste është pushuar çështja apo është dhënë pafajësi; në 2 raste është prishur vendimi dhe kthyer çështja për rigjykim.

-Në **19** raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit ndryshimi i vendimit dhe **rëndimi i pozitës** së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 12 raste ka vendosur lënie në fuqi; në 6 raste ka rënduar pozitën sipas kërimit të prokurorit të apelit; ndërsa në 1 rast ka lehtësuar pozitën e të pandehurit.

-Në **5** raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit ndryshimi i vendimit dhe **lehtësim i pozitës** së të pandehurit, nga Gjykata e Apelit në 5 raste është lehtësuar pozita e të pandehurit, duke pranuar kërkimin e prokurorit, *(bëhet fjalë për vepra penale dhe për persona me rrezikshmëri të ulët shoqërore duke zbutur masën e dënimit dhe aplikimin e alternativave të dënimit me burgim).*

-Në **3** raste, ku është kërkuar nga prokurori i apelit **prishje vendimi dhe kthimi i akteve për rigjykim**, nga Gjykata e Apelit në 2 raste është vendosur lënie në fuqi të vendimit dhe në 1 rast është vendosur prishje vendimi dhe kthim i çështjes për rigjykim.

Analizë mbi apelet e ushtruara nga Prokuroria e Shkallës së Parë për çështjet e themelit :

- Për vitin 2019 janë gjykuar mbi ankimin e prokurorit **22** çështje, *(nga 42 çështje të gjykuara në vitin 2018)*, ku sipas rretheve gjyqësore 11 çështje i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe 11 çështje i përkasin Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Qëndrimi i prokurorit të apelit në përgjithësi ka qënë në mbështetje të ankimit të prokurorit të shkallës së parë dhe nuk ka heqje dorë nga ankimi, ku në **19** raste është kërkuar rëndim pozite; në **2** raste është kërkuar prishje vendimi dhe kthim i akteve për rigjykim; ndërsa në **1** rast prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit *(sepse çështja ka ardhur edhe mbi apelin e të pandehurve).*
- Nga këto, **11** apele të prokurorit janë ushtruar për pafajësi të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë, 1 apel për pushim çështje, 1 apel për ndryshim kualifikimi ligjor të veprës penale dhe 9 apele janë ushtruar për masë të butë dënimi dhe për mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim në lidhje me aplikimin e nenit 59 të K.Penal. Nga 22 rastet e përkrahura të ankimit të prokurorëve për çështjet e themelit rezulton se Gjykata e Apelit ka pranuar 6 prej tyre.

➤ **Apele të ushtruara nga prokurori për vendime pafajësie :**

Janë shqyrtuar 11 çështje mbi apelin e prokurorit për vendime pafajësie të Gjykatës së Shkallës së Parë, nga të cilat :

-Në **4** raste, Gjykata e Apelit ka **pranuar apelin e prokurorit** duke disponuar me rëndimin e pozitës me deklaram fajtor, sipas kërimit të prokurorit të apelit. Çështjet ju përkasin, të pandehurit E.Ç, akuzuar për veprën penale “*Mashtrimi në kredi*”, parashikuar nga neni 146 të K.Penal; të pandehurit Zh.S, etj, akuzuar për veprën penale “*Vjedhja*” parashikuar nga neni 134/2 të K.Penal; të pandehurit person juridik,

akuzuar për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/2 i K.Penal; të pandehurit L.T akuzuar për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 242 i K.Penal.

-Në 7 raste, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkalles së Parë për pafajësi. Për 4 raste çështjet ju përkasin, të pandehurit A.H, akuzuar për veprën penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i K.Penal; të pandehurit L.R, etj akuzuar për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”. parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal; të pandehurit A.D, akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal; të pandehurit B.D, akuzuar për veprën penale “Shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i K.Penal. Për 3 rastet e tjera, ku Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të pafajësisë, bëjnë fjalë për vepra që parashikohen si kundërvajtje penale nga Kodi Penal (nenet 89,205,237). Për rastet që nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit dhe kanë ekzistuar shkaqet ligjore të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë me qëllim njehësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

➤ **Apele të ushtruara nga prokurori, për vendime me ndryshim të kualifikimit ligjor të veprës penale.**

Është shqyrtuar 1 rast mbi apelin e prokurorit, për ndryshim të kualifikimit ligjor të veprës penale, në ngarkim të të pandehurit L.T, akuzuar për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal. Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 të K.Penal. Në këtë rast nga prokurori i apelit është mbështetur apeli për ndryshimin e kualifikimit ligjor dhe duke ju referuar dispozitës materiale dhe praktikës gjyqësore për standartin e krijuar lidhur me subjektet aktiv dhe pasiv të veprës penale “Dhuna në familje”, është ushtruar rekurs për zbatim të gabuar të ligjit penal.

➤ **Apele të ushtruara nga prokurori, për vendime me prishje dhe pushim çështje:**

Është shqyrtuar 1 rast mbi apelin e prokurorit për prishje dhe pushim çështje, në lidhje me çështjen penale në ngarkim të të pandehurës A.Xh, akuzuar për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/ i K.Penal, ku mbi kërkimin e prokurorit të apelit për prishjen dhe kthimin e akteve për rigjykim, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit. Në këtë rast duke qënë se ekzistojnë shkaqet ligjore të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, me qëllim njehësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për shkelje të ligjit.

➤ **Apele të ushtruara nga prokurori, për masë dënimi të butë dhe zbatimin e alternativave të dënimit me burgim.**

Apelet e prokurorit me këtë objekt janë ushtruar kryesisht për mënyrën e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim lidhur me aplikimin e dënimeve alternative dhe për masën e dënimit që ka qënë relativisht e ulët.

-Janë shqyrtuar **9** raste mbi apelin e prokurorit, për ndryshim vendimi në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, nga të cilat në 3 raste për ashpërsim dënimi dhe në 6 raste për të ndryshuar mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim, ku Gjykata e Apelit ka disponuar si më poshtë :

-Në **2** raste është pranuar apeli i prokurorit nga Gjykata e Apelit, ku në 1 rast ka ndryshuar vendimin duke ashpërsuar masën e dënimit në ngarkim të të pandehurit E.M akuzuar për veprën penale parashikuar nga neni 89 e 25 i K.Penal (*pasi ka qënë përsëritës dhe ka kryer veprën në rrethana rënduese*) dhe në 1 rast ka ndryshuar vendimin në lidhje me caktimin e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim në ngarkim të të pandehurit S.V etj, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal.

-Në **1** rast ku çështja është shqyrtuar mbi apelin e prokurorit (*për mosaplikim të nenit 59 të K.Penal për një prej të pandehurve*) dhe njëkohësisht mbi apelin e të pandehurve, mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar duke prishur dhe pushuar çështjen, në ngarkim të të pandehurve T.A etj akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyres”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

-Në **6** raste, është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, i apeluar nga prokurori për masë dënimi dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal. Në përgjithësi, ato kanë qënë të lidhura me kryerjen e veprave penale të parashikuar nga nenet 130/a/4, 150, 189/2, 283/1, 290/2 të Kodit Penal, ku prokuroria në këto raste e ka mbështetur dënimin me burgim për të qënë koherente me politikën e ashpër të dënimit në zbatim dhe të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave. Në të gjitha rastet kur kanë ekzistuar shkaqet ligjore të parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë për shkelje të ligjit.

-Analizë mbi apelet e të pandehurve dhe lehtësimin e pozitës së të pandehurit vendosur nga gjykata:

- Në 73 çështje të apeluara nga të pandehurit, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke rrëzuar kërkimin e tyre për lehtësim të pozitës.
- Në 22 raste Gjykata e Apelit ka vendosur lehtësim të pozitës, me zbutje dënimi.
- Në 5 raste, nga Gjykata e Apelit është ndryshuar vendimi dhe është dhënë pafajësi ose është pushuar çështja.
- Në 2 raste nga Gjykata e Apelit është ndryshuar vendimi dhe është disponuar për prishjen e vendimit dhe kthim çështje për rigjykim.
- Në 1 rast të shqyrtuar mbi apelin e të pandehurit është kërkuar nga prokurori i apelit prishje dhe kthim i akteve për shkelje procedurale dhe nga Gjykata e Apelit është disponuar nga me prishje kthim për rigjykim.
- Nga 5 raste, Gjykata e Apelit ka disponuar për lehtësim të pozitës së të pandehurit, duke pranuar në 5 prej tyre dhe kërkesën e prokurorit për zbutje të dënimit që lidhen me vepra penale me rrezikshmëri të ulët, si dhe kur kanë ekzistuar kushtet dhe kriteret për aplikimin e neneve 59 apo 63 të K.Penal dhe veçanërisht për aplikimin e nenit 53/a të K.Penal, zëvendësimin e dënimit me burgim me një shumë të hollash në favor të shtetit, si një nga alternativat specifike të dënimit me burgim në lidhje me veprën penale “Drejtimi i

automjeteve në gjëndje të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal. Po kështu, lehtësimi i pozitës lidhet dhe me rastet kur të pandehur janë femra apo të mitur në konflikt me ligjin.

- Në përgjithësi, lehtësimi i pozitës lidhet me çështje të shqyrtuara në Gjykatën e Apelit, mbi apelin e të pandehurve, kryesisht për masën e dënimit dhe mënyrën e ekzekutimit të dënimit me burgim, për kryerjen e veprave penale të parashikuar nga nenet 291; 305; 174/1; 298/3; 298/2; 284/2; 290/4; 88/1; 139 të K.Penal. Në rastet kur është vlerësuar zbatimi i gabuar i ligjit material apo procedural penal, është ushtruar rekurs nga Prokuroria e Apelit Korçë.
- Gjatë shqyrtimit të çështjeve të themelit, Prokuroria e Apelit Korçë ka pasur pikësynim paraqitjen me cilësi të konkluzioneve, si në rastet kur është kërkuar lënie në fuqi të vendimit, por sidomos në çështjet ku është dhënë pafajësi dhe është argumentuar e kundërta, apo edhe në rastet kur është kërkuar ndryshim i kualifikimit ligjor. Në përgjithësi, apelet e ushtruara nga Prokuroritë e Shkallës së Parë kanë qënë ligjore dhe janë mbështetur nga ana jonë, por ka vënd për përmirësim, kjo pasi shpesh herë, apelet janë bërë objekt i diskutimit me prokuroret, pasi konstatohen problematika për mënyrën e formulimit, shkaqet e ankimit në kundërshtim të vendimit të Gjykatës, si dhe për të plotësuar apelin sipas nenit 415 të K.Pr.Penale, sepse konstatohet që apeli ushtrohet nga prokuroret pa u njohur me arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Plotësimi i kësaj kërkesë bëhet imediate referuar përcaktimeve të nenit 425 të K.Pr.Penale me titull “Kufijtë e shqyrtimit të çështjes” si dhe të nenit 426/a/6 të K.Pr.Penale, ku përcaktohet se Gjykata e Apelit shqyrton çështjen brënda shkaqeve të ngritura në ankim dhe palët nuk mund të parashtrojnë në seancë shkaqe tej atyre të ngritura në apel. Për apelet që ushtrojnë prokuroret për pafajësi duhet të mbahet parasysh neni 427 i K.Pr.Penale, ku prokuroret në aktin e apelit të pasqyrojnë edhe kërkimin për përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Vlen të përmendet fakti, se përpos numrit të ulët të apeleve të prokurorit, nuk konstatohet ushtrimi i apeleve kundërshtuese nga prokuroret në referim të nenit 423 të K.Pr.Penale.
- Bazuar në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm konstatohen në apel kërkesa të pakta të prokurorisë për gjykime të drejtpërdrejta, sidomos për çështjet ku hetimi përfundon brënda kohës së “Arrestit në flagrance” dhe lidhet me çështje fakti, apo gjykimi me marrëveshje dhe urdhri penal si institute të reja në procesin penal.
- Prokuroret e Apelit kanë respektuar afatet ligjore të gjykimit të çështjes duke mos u bërë pengesë në asnjë rast, për shtyrjen e procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit.
- Aplikimi i alternativave të dënimit duhet parë me përparësi kur janë kushtet dhe kriteret sipas dispozitave të posaçme (nenet 53/a, 59, 63 etj) dhe për vepra penale dhe autorë me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Kjo vjen edhe si kërkesë e kohës në zbatim të Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, por dhe standarteve ndërkombëtare.

- Ndryshe trajtohen personat shoqërisht të rrezikshëm, përsëritës në krim apo persona që kryejnë vepra penale për të cilat shoqëria është e ndjeshme (*duke përmendur dhunën në familje, krimet kundër personit veçanërisht vrasjet, veprat penale që lidhen me trafikim të lëndëve narkotike, trafikimi i qënieve njerëzore, korrupsioni, krimi ekonomik etj*). Apelet e ushtruara nga prokurorët për këto vepra penale mbështeten, por edhe në rastet kur nga gjykata është lehtësuar pozita e të pandehurit me ulje të dënimit është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.
- Në rastet kur subjekti është i mitur, një rëndësi të veçantë merr zbatimi i masave alternative për shmangien nga ndjekja penale të të miturit të përcaktuara në Kodin Drejtësisë Penale për të Mitur, ku një rol kyç për këtë qëllim përcakton dhe prania e aktoreve të tjerë në shërbim të dhënies së drejtësisë apo dhe interesit më të lartë të fëmijës, veç subjekteve procedurale prokurori dhe gjykatë, duke respektuar të drejtat procedurale të të miturit viktimë, të miturit në konflikt me ligjin dhe të miturit dëshmitar, si dhe për të krijuar një standart për një proces të rregullt ligjor. Gjithashtu, për të patur efektivitet në lidhje me çështjet penale me të mitur në konflikt me ligjin mendoj se duhet të krijohet një sistem të dhënash statistikore të veçanta, me qëllim për të krijuar një politikë penale të unifikuar në raport me kategorinë e veprave penale dhe moshën e subjekteve të mitur në konflikt me ligjin.

II. ANALIZA E TREGUESVE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT ÇAKTIM MASE SIGURIMI.

Viti 2019 ka pasur një ulje të përfaqësimit të çështjeve me objekt masa sigurimi. Këtë vit, janë regjistruar **128** masa sigurimi, nga **158** që janë regjistruar në vitin 2019.

Janë shqyrtuar dhe përfunduar gjithësej **128** masa sigurimi.

Masat e sigurimit në **6** raste, janë shqyrtuar mbi apelin e prokurorit dhe në **124** raste mbi apelin e personave nën hetim.

- Në **7** raste është kërkuar nga prokurori i Apelit ndryshim i masës së sigurimit, nga të cilat **6** raste (*mbi apelin e prokurorit*) për masë më të rëndë sigurimi “Arrest në burg” dhe **1** rast për masë më të butë sigurimi (*mbi apelin e të pandehurit*). Në **1** rast është pranuar apli i prokurorit, duke vendosur Gjykata e Apelit “Arrest në burg”, në **3** raste është vendosur masë me e butë sigurimi, ndërsa në **3** raste është miratuar vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë.
- Në **10** raste, mbi ankimin e të pandehurit, është disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga ankimi.
- Në **111** raste është kërkuar nga prokurori i apelit miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë, ku nga Gjykata e Apelit në **69** raste është vendosur miratim vendimi; në **42** raste është ndryshuar masa e sigurimit “Arrest në burg” me një masë sigurimi më të butë. Vlen të theksohet se nuk ka disponim nga Gjykata e Apelit për shfuqizim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë. Për **11** raste kur është konstatuar zbatim i gabuar i ligjit është ushtruar rekurs.
- Në gjykimet me këtë objekt, Prokuroria e Apelit Korçë orientohet në zbatimin me korrektësi jo vetëm të nenit 228 e 229 të K.Pr.Penale, por sidomos të kërkesave të nenit 230 të K.Pr.Penale, lidhur me kriteret e veçanta të “Arrestit

- në burg”. Megjithatë duhet të tregohet kujdes në aplikimin e kësaj mase sigurimi.
- Në respektim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe siç rekomandon Këshilli i Ministrave, kërkesa për masën e sigurimit “Arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më të shkurtër të mundshme; Ashpërsim të masës së sigurimit/dënimit ndaj personave me rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe për vepra penale që parashikojnë masë dënimi në minimum mbi 5 vjet burgim;
 - Krahas llojeve të tjera të masave të sigurimit në veçanti konstatohet zbatimi i masës së sigurimit “Garanci pasurore” nga gjykata. Garancia pasurore sipas nenit 236/1 i K.Pr.Penale, e kushtëzon zëvendësimin e masës arrest në burg ose në shtëpi kur është vendosur vetëm për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes. Gjithsesi konstatohen raste ku Gjykata e Apelit ka zëvendësuar arrestin në burg me garanci pasurore edhe pse kanë ekzistuar shkaqe të tjera të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, apo rreziku i përsëritjes së veprës penale. Këto raste janë bërë objekt rekursi për zbatim të gabuar të ligjit.

III. ANALIZË MBI ÇËSHTJET E KATEGORIZUARA TË VEÇANTA :

Për vitin 2019 janë përfunduar **111** çështje të kategorizuara të veçanta ku përfshihen çështje penale me objekt vendimi mosfillimi, lirim me kusht, çështje që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit etj, si dhe çështjet me viktive akuzuese, nga të cilat **7** çështje mbi apelin e prokurorit dhe **104** mbi apelin e të pandehurit ose kërkesa të palëve në proces. Për çështjet me këtë objekt janë ushtruar 5 rekurse për zbatim të gabuar të ligjit.

➤ Analizë për çështjet e veçanta mbi apelin e prokurorit:

-Në **3** raste është përkratur ankimi i prokurorit nga prokurori i apelit, ku në **2** raste Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e ankimit sipas apelit të prokurorit dhe në **1** rast ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Në 2 apelet e pranuar të prokurorit, në 1 rast bëhet fjalë për çështje me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe duke lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të prokurorit, si dhe në 1 rast me objekt “Lirim me kusht”, në ngarkim të dënuarit me burgim të përjetshëm G.Gj, Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e prokurorit duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe rrezimin e kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm.

-Në **2** raste me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit nuk është përkratur ankimi i prokurorit, duke hequr dorë prokurori i apelit, për shkak se vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi nuk kanë ekzistuar rrethana për mosfillimin e procedimit duke urdhëruar regjistrimin e tij.

-Në **2** raste me objekt ankim kundër vendimit të mosfillimit, mbi kërkimin e prokurorit të apelit është disponuar nga Gjykata e Apelit me mospranim ankimi të prokurorit, për shkak se ankimi është paraqitur jashtë afatit ligjor 10 ditor (*neni 290, pika 2 i K.Pr.Penale*).

➤ **Analizë për çështjet e veçanta me apel të palëve në proces :**

Janë përfunduar **104** çështje mbi apelin e të dënuarve, të viktimave akuzuese ose të pandehurve me kërkesa në fazën e ekzekutimit të dënimit.

-Nga këto janë gjykuar **19** raste me objekt "*Lirim me kusht*", ku mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi të vendimit, në 4 raste Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe është ushtruar rekurs për shkelje të ligjit. Çështjet me objekt "*Lirim me kusht*", bazuar në nenin 64 të K.Penal, janë të shpeshta në Gjykatën e Apelit, kryesisht të apeluara nga të dënuarit. Në këtë lloj gjykimesh, prokuroret janë treguar të kujdesshëm jo vetëm në respektim të kërkesave të nenit 64 të K.Penal, por edhe në respektim të vendimit unifikues Nr.2, Datë 25.05.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të vendosur për këtë objekt. Për rastet kur Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në zbatim të gabuar të ligjit, nga ana jonë është ushtruar rekurs.

-Për çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të mosfillimit*" janë gjykuar **21** çështje, nga këto 19 raste janë lënë në fuqi dhe në 2 raste mbi kërkimin e prokurorit për ndryshimin e vendimit Gjykata e Apelit ka pranuar kërkimin e prokurorit të apelit për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal.

Në çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të mosfillimit*", kemi vlerësuar shkaqet ligjore nëse duhet të vendoset regjistrimi i procedimit penal nga prokurori apo jemi para kushteve ligjore të mosfillimit të procedimit në kuptim të nenit 290 të K.Pr.Penale. Gjithashtu, janë kontrolluar vendimet e mosfillimit në respektim të afateve ligjore detyruese të përcaktuar në K.Pr.Penale që lidhen me marrjen e vendimit të mosfillimit nga prokurori, njoftimin e personave që legjitimohen të ushtrojnë të drejtën e ankimit dhe afatin e tij.

-Për çështjet *me viktimë akuzuese* janë gjykuar **12** raste, ku në 7 raste është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë; në 1 rast mbi kërkimin e prokurorit, është ndryshuar vendimi në favor të viktimës akuzuese duke u dekluar fajtor i akuzuari; në 1 rast është ndryshuar masa e dënimit; në 2 raste mbi kërkimin e prokurorit të apelit është pushuar çështja dhe në 1 rast mbi kërkimin e prokurorit të apelit është vendosur nga Gjykata e Apelit prishje dhe kthim aktesh për shkelje proceduriale.

Çështjet që lidhen me viktimën akuzuese, procesi është orientuar sipas nenit 59 të K.Pr.Penale dhe prokurori ka ushtruar funksionin brenda kufijve të parashikuara nga kjo dispozitë, por gjithmonë me një rol aktiv në respektim të parimit të ligjshmërisë për të dhënë mendim, lidhur me fajësinë e të akzuarit, me vlerësimin e provave të paraqitura nga palet në proces, apo dhe me dhënien e mendimit për masën e dënimit.

-Në **52** raste çështjet janë shqyrtuar me objekte të ndryshëm kryesisht me kërkesa në fazën e ekzekutimit, mbarim i afateve të paraburgimit, bashkim dënimesh, shtyrje ekzekutim dënimi, shuarje mase, etj.

-Në çështjet me objekt "*Ankim kundër vendimit të pushimit*" ku hetimi paraprak kontrollohet nga gjykata, me ndryshimet në K.Pr.Penale ato zgjidhen në Gjykatën e Apelit në dhomën e këshillimit.

IV. ANALIZË SIPAS KATEGORISË SË VEPRAVE PENALE NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE PRIORITARE PËR VITIN 2019 NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT:

I. Lidhur me veprat penale kundër korrupsionit për vitin 2019, janë regjistruar 4 çështje themeli, ku 1 çështje ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec dhe 3 çështje ardhur nga Gjykata e Shkallës së Parë Korçë dhe konkretisht;

-Për veprën penale “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga Neni 259 i K.Penal janë gjykuar 3 çështje me 3 të pandehur. -Në një rast çështja është gjykuar mbi apelin e prokurorit për pafajësi, në ngarkim të të pandehurit A.H. Prokurori i apelit ka mbështetur ankimin e prokurorit për ndryshimin e vendimit dhe deklarinimin fajtor të të pandehurit, kurse Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs për zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material penal.

-Në 2 rastet e tjera, çështja është gjykuar mbi apelin e të pandehurve, në ngarkim të të pandehurit F.G (*për zbutje dënimi*) dhe të pandehurit I.F (*për pafajësi*). Qëndrimi i prokurorit të apelit dhe vendimi i Gjykatës së Apelit është për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

-Për veprën penale “*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*”, parashikuar nga Neni 245/1 i K.Penal, është gjykuar një çështje, me një të pandehur. Kjo çështje ka ardhur mbi apelin e të pandehurit A.K., vetëm për mënyrën e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim duke kërkuar aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

II. Lidhur me veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, janë gjykuar 3 (tre) çështje me 9 (nëntë) të pandehur.

-Në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e katër të pandehurve dhe mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi përse i përket fajësisë dhe llojit e masës së dënimit, kurse për një të pandehur ka aplikuar nenin 59 të K.Penal.

-Në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit (*lidhur me mënyrën e ekzekutimit të vendimit me burgim për një nga të pandehurit*) dhe njëkohësisht apelin e tre të pandehurve, ku mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar me prishje e pushim çështje dhe ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga Prokuroria e Apelit.

-Në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e të pandehurit G.K, ku qëndrimi i prokurorit ka qënë për lënie në fuqi të vendimit dhe Gjykata e Apelit ka lehtësuar pozitën e të pandehurit duke aplikuar nenin 63 të K.Penal.

-Lidhur me çështjet e përfunduara me objekt Masa Sigurimi për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i K.Penal, janë gjykuar dy çështje me dy të arrestuar, ardhur mbi apelin e të arrestuarve. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi.

III. Lidhur me veprat penale kundër narkotikeve, për vitin 2019, janë gjykuar 15 çështje themeli, si më poshtë :

-Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga Neni 283/1 i K.Penal, janë gjykuar 11 çështje me 11 të pandehur, 6 prej tyre me masën e sigurimit “Arrest në burg” dhe një me “Arrest në shtëpi”. Në 3 raste çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit, ku një rast për fajësi dhe në dy raste për aplikim të gabuar të nenit 59 të K.Penal, apele të mbështetura nga prokurori i apelit. Ndërsa në 8 raste çështja ka

ardhur mbi apelin e të pandehurve. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit në 8 raste për lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit ka disponuar në 4 raste për lënie në fuqi, 3 raste ka lehtësuar pozitën me aplikimin e nenit 59 dhe në 1 rast është vendosur prishje e pushim çështje. Për 2 raste që prokurori i apelit ka kërkuar rëndim pozite, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit. Në një rast, prokurori ka kërkuar prishje kthim të akteve, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit. Për 3 raste është ushtruar rekurs për shkelje të ligjit procedural dhe material penal. Kryesisht në rastet kur është lehtësuar pozita bëhet fjalë për sasi të vogël të lëndës narkotike, në formën e mbajtjes në kundërshtim me ligjin dhe me qëllim përdorimi vetjak.

-Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 283/2 i K.Penal, janë gjykuar 3 çështje me 7 të pandehur, 7 prej tyre me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Këto raste kanë ardhur mbi apelin e të pandehurve, kryesisht për zbutjen e masës së denimit. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit në këto tre raste, duke mos pranuar apelin e të pandehurve për lehtësimin e pozitës.

-Për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, parashikuar nga Neni 284/3 i K.Penal, është gjykuar 1 çështje me 1 të pandehur, të arrestuar (në mungesë). Çështja vjen mbi apelin e të pandehurit për ndryshimin e kualifikimit ligjor dhe prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar për prishjen e kthimin e akteve për rigjykim. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs për zbatim të gabuar të ligjit.

Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit janë këto të dhëna:

-Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal; janë gjykuar 13 çështje masa sigurimi mbi apelin e 13 shtetasve të arrestuar. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit për 13 raste, kurse Gjykata e Apelit në 5 raste ka pranuar kërkesën e prokurorit për miratim vendimi, në 8 raste ka disponuar me ndryshimin e vendimit, duke zbutur llojin e masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Garanci pasurore”, të parashikuar nga neni 236 i K.Pr.Penale dhe “Detyrim paraqitje” të parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Për një rast duke e konsideruar vendimin e Gjykatës së Apelit në zbatim të gabuar të dispozitave procedurale parashikuar nga nenet 228, 229 dhe 230 të K.Pr.Penale është ushtruar rekurs nga prokurori i apelit, konkretisht lidhur me çështjen në ngarkim të personit nën hetim Th.Dh, hetuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal në formën e transportimit të sasisë prej 46 kg lëndë narkotike të dyshuar cannabis sattiva.

-Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 të K.Penal; janë gjykuar 9 çështje masa sigurimi mbi apelin e 9 të arrestuarve. Në një rast është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga shtetasi nën hetim. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në 8 raste dhe Gjykata e Apelit në 3 raste ka pranuar kërkesën e prokurorit për miratuar vendimin, ndërsa në 5 raste ka lehtësuar pozitën duke ndryshuar llojin e masës së sigurimit. Kryesisht, në rastet kur është zbutur lloji i masës së sigurimit nga Gjykata e Apelit bëhet fjalë për sasi të vogël të lëndës narkotike, në formën e mbajtjes në kundërshtim me ligjin dhe me qëllim përdorimi vetjak.

-Për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, parashikuar nga neni 284/2 i K.Penal; janë gjykuar 5 çështje me objekt masa sigurimi, mbi apelin e 5 të arrestuarve. Prokurori i apelit ka kërkuar në 5 rastet miratim vendimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi.

IV.Lidhur me veprat penale kundër krimit të organizuar për vitin 2019, janë gjykuar 2 çështje themeli, për veprën penale “*Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale*”, parashikuar nga neni 287/b/1 i K.Penal, me tre të pandehur, një prej tyre me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Çështja është gjykuar mbi apelin e dy të pandehurve për masë më të butë dënimi. Në një rast mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit dhe në rastin tjetër Gjykata ka vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga ankimi i të pandehurit.

-Lidhur me çështjet e përfunduara me objekt caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, janë gjykuar 2 çështje për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal. Prokurori i apelit në 2 rastet ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për vendosjen e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” dhe Gjykata e Apelit ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke disponuar me miratim vendimi. Në një rast sekuestro preventive në ngarkim të shtetasve nën hetim A.D, V.D dhe F.C lidhet me sekuestrimin e shtatë pasurive të paluajtshme, kurse në rastin tjetër është vendosur sekuestro preventive mbi llogarite bankare të shtetasit nën hetim Th.V, në Banken Credins në gjëndje totale rreth 450.000 euro.

-Janë gjykuar dy çështje me objekt caktim masë sigurimi për qëllime ekstradimi. Të dy rastet janë në ngarkim të shtetasit nën hetim A.J.H, kërkuar nga Autoritetet e Drejtësisë Gjermane, akuzuar për vepra penale të fshehjes së të ardhurave dhe evazion fiskal në disa raste në kuadër të grupit të strukturuar kriminal (nenet 180 dhe 334 të K.Penal të R.SH). Çështja ka ardhur mbi apelin e shtetasit nën hetim për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi në të dy rastet dhe Gjykata e Apelit ka miratuar vendimin për masën e sigurimit “Arrest në burg”.

V.Lidhur me veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, janë gjykuar dy çështje me objekt masa sigurimi për veprën penale “Rebelim i të burgosurve”, parashikuar nga neni 270 i K.Penal. Në dy rastet çështjet kanë ardhur mbi apelin e të dënuarve A.LI dhe A.S që vuajnë dënim për vepra penale të rënda dhe mbi kërkimin e Prokurorit të apelit për miratimin e vendimit Gjykata e Apelit ka disponuar për miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

-Për periudhën e zbatimit të ligjit nr.108/2018, për vendosjen në regjimin e posaçëm të të dënuarve/paraburgosurve; janë gjykuar 3 raste me objekt “*Konfirmimin e masës së përkohshme për vendosjen e të dënuarve, nën regjimin e mbikqyrjes së veçantë*”. Mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

-Gjithashtu, është gjykuar një rast me objekt “*Lirim me kusht*”, ku Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka pranuar kërkesën e të dënuarit me burgim të përjetshëm G.Gj. Çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit (*i cili është mbështetur nga prokurori i apelit*) dhe Gjykata e Apelit ka pranuar apelin e prokurorit duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht të të dënuarit me burgim të përjetshëm.

VI. Lidhur me veprat penale “Mbajtja pa lejë dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278 të K.Penal, për vitin 2019, janë gjykuar 4 (katër) çështje themeli, me 5 (pesë) të pandehur, të arrestuar.

-Për nenin 278/1 i K.Penal janë gjykuar 3 (tre) çështje, me 4 (katër) të pandehur të arrestuar, mbi apelin e të pandehurve për zbutje dënimi, ku në një rast është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri. Në dy raste mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi, Gjykata e Apelit ka disponuar për lënie në fuqi të vendimit, duke mos pranuar apelin e të pandehurve për lehtësimin e pozitës.

-Për nenin 278/4 i K.Penal është gjykuar 1 çështje, me 1 të pandehur të arrestuar, mbi apelin e të pandehurit për zbutje dënimi, ku për këtë rast është vendosur mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri.

-Lidhur me çështjet e përfunduara për Masat e Sigurimit :

Për veprën penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit*”, parashikuar nga neni 278/1 i K.Penal; janë gjykuar 4 çështje me objekt caktim mase sigurimi, ardhur 2 çështje mbi apelin e të pandehurve dhe 2 çështje mbi apelin e prokurorit (të mbështetur nga prokurori i apelit). Në këto dy raste prokurori i apelit ka kërkuar rëndimin e pozitës, për ndryshimin e masës së sigurimit me arrest në burg, kurse Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi. Në 2 raste mbi kërkimin e prokurorit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi në një rast dhe në një rast me ndryshim vendimi me masë më të butë.

Për veprën penale “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive*”, parashikuar nga neni 280 i K.Penal, janë gjykuar dy çështje me objekt masë sigurimi, mbi apelin e të pandehurve. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi, Gjykata e Apelit ka disponuar në një rast me miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në rastin tjetër me ndryshim vendimi me masë më të butë.

VII. Lidhur me veprat penale “Krime seksuale”, kundër lirisë së personit dhe kundër fëmijëve dhe familjes, për vitin 2019, janë gjykuar çështjet e mëposhtme, sipas neneve përkatëse të K.Penal.

A. Për veprën penale “*Vepra të turpshme*”, e parashikuar nga neni 108/1 i K.Penal, është gjykuar një çështje themeli mbi apelin e të pandehurit N.Zh, i cili ka kërkuar zbutje dënimi. Prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit.

B. Për veprën penale “*Përndjekja*”, e parashikuar nga neni 121/a i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 2 çështje themeli, me dy të pandehur të arrestuar. Për të dy rastet çështjet kanë ardhur mbi apelin e të pandehurve për zbutje të masës së dënimit për veprën e kryer. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për lënie në fuqi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi për të dy rastet.

- Lidhur me masat e sigurimit për veprat penale të “*Krimeve Seksuale*” janë gjykuar 2 çështje si më poshtë :

-Për veprën penale “*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur*”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal, është gjykuar një çështje, me të pandehur A.D, i cili ka apeluar për ndryshim të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratim vendimi “Arrest në burg”, ndërsa Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin, duke lehtësuar pozitën me masë më të butë.

-Për veprën penale “*Ngacmimi seksual*”, parashikuar nga neni 108/a/1 i K.Penal, është gjykuar një çështje, mbi apelin e të pandehurit G.V, i cili ka kërkuar ndryshimin e

vendimit me masë më të butë sigurimi. Prokurori i Apelit ka kërkuar miratimin e vendimit dhe Gjykata e Apelit ka miratuar vendimin objekt ankimi.

-Për veprën penale “*Heqja e paligjshme e lirisë*”, parashikuar nga neni 110/2 i K.Penal, është gjykuar një çështje, mbi apelin e të pandehurit I.B, i cili ka kërkuar ndryshimin e llojit të masës së sigurimit. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për miratim vendimi.

-Për veprën penale “*Përndjekja*”, e parashikuar nga neni 121/a i K.Penal, janë gjykuar 3 (tre) çështje mbi apelin e personave nën hetim. Për të 3 rastet prokurori i apelit ka kërkuar miratim vendimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi në dy raste dhe në një rast me ndryshim vendimi me masë më të butë.

-Për veprën penale “*Keqtrajtimi i të miturit*”, parashikuar nga neni 124/b/1, është gjykuar një rast mbi apelin e shtetasit nën hetim, duke kërkuar ndryshimin e vendimit për masë të butë sigurimi. Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke mbështetur qëndrimin e prokurorit të apelit për miratim vendimi.

-Për veprën penale “*Shfrytëzimi i prostitucionit*”, e parashikuar nga neni 114/2 i K.Penal, janë gjykuar 2 çështje, me dy të arrestuar, çështja është gjykuar mbi apelin e shtetasve nën hetim, të cilët kanë kërkuar një masë më të butë sigurimi personal. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për miratim vendimi.

-Për veprën penale “*Trafikimi i të miturve*”, e parashikuar nga neni 128/b/3 i K.Penal, janë gjykuar 2 çështje, me dy të arrestuar, çështja është gjykuar mbi apelin e shtetasve nën hetim, të cilët kanë kërkuar një masë më të butë sigurimi personal. Gjykata e Apelit Korçë, për një rast ka disponuar me miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit për miratim vendimi dhe në rastin tjetër ka zbutur llojin e masës së sigurimit për shtetasen R.M.

VIII. Lidhur me veprat penale kundër “Dhunës në familje” për vitin 2019, janë gjykuar 22 çështje themeli, ku në përgjithësi konstatohet një qëndrim i ashpër në politikën penale të dënimit dhe masave të sigurimit;

-Për veprën penale “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal, janë gjykuar 13 çështje themeli, me 13 të pandehur me masë sigurimi “Arrest në burg”. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e të pandehurve për zbutjen e dënimit ose aplikimin e alternativës së dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i K.Penal. Në 9 raste, prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në tre raste ka kërkuar mospranim ankimi, për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri. Gjykata e Apelit Korçë ka disponuar me lënie në fuqi në 9 raste dhe në tre raste ka disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga të pandehurit. Një çështje vjen mbi apelin e prokurorit (*për masë dënimi*) ku prokurori i apelit ka kërkuar rëndimin e pozitës me masë më të ashpër dënimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit.

-Për veprën penale “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/1 i K.Penal, janë gjykuar 7 çështje themeli, me 8 të pandehur, 2 prej tyre të arrestuar. Çështjet janë gjykuar mbi apelin e 7 të pandehurve që kanë kërkuar zbutjen e dënimit dhe në një rast është kërkuar pafajësi. Prokurori i apelit në 6 raste ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, kurse Gjykata e Apelit në 5 raste ka disponuar për lënie në fuqi dhe në një rast ka lehtësuar pozitën, duke aplikuar nenin 59 të K.Penal. Në një rast është disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga i pandehuri.

-Për veprën penale “*Dhuna në familje*”, parashikuar nga neni 130/a/3 i K.Penal, janë gjykuar 2 çështje themeli, me 2 të pandehur, 1 prej tyre i arrestuar. Në një rast çështja

ka ardhur mbi apelin e të pandehurit për zbutje dënimi dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me mospranim ankimi për shkak të heqjes dore nga i pandehuri. Në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit për ndryshim kualifikimi (*të mbështetur nga prokurori i apelit*) Gjykata e Apelit ka disponuar me lënie në fuqi të vendimit dhe për shkelje të ligjit është ushtruar rekurs nga prokurori.

-Lidhur me masat e sigurimit të përfunduara në vitin 2019, për veprat penale të “Dhunës në familje”, rezulton se janë gjykuar 9 çështje ku :

-Për nenin 130/a/3 të K.Penal, është gjykuar 1 çështje mbi apelin e shtetasit nën hetim për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit e ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke disponuar me miratim vendimi.

-Për nenin 130/a/4 të K.Penal, janë gjykuar 4 çështje, mbi apelin e 4 shtetasve të arrestuar. Gjykata e Apelit ka mbështetur në tre raste kërkesën e prokurorit të apelit për miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë/Pogradec dhe në një rast ka ndyshuar llojin e masës së sigurimit, ku për këtë rast është ushtruar rekurs.

-Për nenin 130/a/1 të K.Penal janë gjykuar 4 çështje masa sigurimi, të ardhura për gjykim mbi apelin e 4 të arrestuarve për zbutje të llojit të masës së sigurimit. Në të 4 rastet prokurori i apeli ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar për 2 raste miratimin e vendimit duke mbështetur kërkesën e prokurorit të apelit, ndërsa në 2 rastet e tjera, Gjykata e Apelit ka zbutur llojin e masës së sigurimit.

IX.Lidhur me veprat penale “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/2/3 i K.Penal, janë gjykuar 2 çështje themeli, me tre të pandehur, një prej tyre me masën e sigurimit “Arrest në burg”. Për të dy rastet kanë bërë apel të pandehurit duke kërkuar pafajësi dhe aplikim të nenit 59. Në dy rastet, prokurori i apelit ka kërkuar lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, por Gjykata e Apelit ka disponuar me ndryshim vendimi duke lehtësuar pozitën e të pandehurit në një rast dhe në rastin tjetër me prishje e kthim për rigjykim. Për dy rastet është ushtruar rekurs për shkelje të ligjit.

-Lidhur me masat e sigurimit, për veprat penale “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/2 i K.Penal, rezulton se për vitin 2019 janë gjykuar 2 çështje, me 2 persona të arrestuar, ku në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e prokurorit për caktimin e masës “Arrest në burg”, ky apel është mbështetur nga prokurori i apelit dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me miratim vendimi, në një rast çështja ka ardhur mbi apelin e shtetasit nën hetim, ku mbi kërkimin e prokurorit të apelit është disponuar me miratim vendimi.

-Për vepër penale “Ndhima për kalim të paligjshëm të kufijve”, parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal, rezulton se për vitin 2019 të kërkuar janë gjykuar 9 çështje me objekt caktim mase sigurimi me 9 persona të arrestuar, të cilat kanë ardhur mbi apelin e shtetasve nën hetim dhe Gjykata e Apelit ka disponuar me 2 raste me mospranim ankimi për shkak të heqjes dorë nga shtetasit dhe në 7 raste mbi kërkimin e prokurorit për miratim, Gjykata e ka mbështetur kërkesën e prokurorit.

-Për keto vepra penale, si për masat e sigurimit dhe themeli, konstatohet qëndrim i ashper i prokurorit të apelit, si rrjedhojë e faktit se ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve në kushtet aktuale është kthyer në një fenomen shqetësues që konsiston në transportimin dhe shoqërimin kundrejt fitimit, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufijve të shtetasve të huaj nëpërmjet kufirit shqiptar me destinacion vendet e BE-së, duke diktuar si domosdoshmëri ashpërsimin e luftës kundër këtij krimi, por dhe

parandalimin e veprimtarisë së organizuar kriminale nga grupe të caktuara, të cilët veprojnë me qëllim për të përfituar nga kjo situatë dhe nga viktimat e veprës penale.

X.Lidhur me veprat penale “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”, parashikuar nga neni 175 i K.Penal, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar 4 masa sigurimi, me 4 të arrestuar. Kjo çështje ka ardhur mbi apelin e të pandehurve për zbutje të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërsa Gjykata e Apelit ka disponuar me ndryshimin e llojit të masës së sigurimit nga “Arrest në burg” në “Garanci pasusore”, për katër shtetasit e arrestuar : Sh.D, B.H, J.K, Y.R. Për këtë çështje nga prokurori i apelit është ushtruar rekurs për shkelje të ligjit.

-Lidhur me rekomandimet për ashpërsimin e dënimit për veprat penale që prekin zgjedhje të lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, Prokuroria e Apelit Korçë ka gjykuar një masë sigurimi për shtetasin nën hetim K.K, i akuzuar për veprën penale “*Pengimi i subjekteve zgjedhore*”, e parashikuar nga neni 325 i K.Penal. Kjo çështje ka ardhur mbi apelin e shtetasit nën hetim duke kërkuar ndryshimin e vendimit duke deklaruar të paligjshëm arrestin në flagrance dhe heqjen e masës së sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata e Apelit ka mbështetur kërkesën e prokurorit duke miratuar vendimin për të dy disponimet e gjykatës.

-Për vitin 2019 është gjykuar vetëm një rast me objekt “*Miratimin e urdhërit penal*”, mbi ankimin e të pandehurit pandehurit M.P, i dënuar për kundërvajtjen penale të parashikuar nga neni 242 i K.Penal. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit, Gjykata e Apelit ka disponuar për deklarimin e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente (Gjykatës së Shkallës së Parë) për shkak se miratimi i urdhërit penal kundërshtohet nga i pandehuri tek e njëjta gjykatë brënda 10 ditëve nga marrja dijani.

-Në gjykimet e rasteve me të mitur në konflikt me ligjin është gjykuar një çështje themeli, me tre të pandehur, dy prej tyre të mitur, akuzuar për veprën penale “*Vjedhja*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i K.Penal. Kjo çështje ka ardhur mbi ankimin e prokurorit për mënyrën e caktimit të dënimit për dy të miturit në konflikt me ligjin në mbështetje të K.Dr.P.M. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit, Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin e prokurorit, duke caktuar dënimin sipas dispozitës përkatëse materiale dhe në bazë të nenit 101 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ka aplikuar alternativën e dënimit.

-Është gjykuar një rast me objekt masë sigurimi (me afat), për të miturin në konflikt me ligjin A.K, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Plagosje e rëndë me dashje*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 88/1-25 i K.Penal. Çështja ka ardhur mbi apelin e të arrestuarit për ndryshim të llojit të masës së sigurimit. Prokurori i apelit ka kërkuar miratimin e vendimit, ndërsa Gjykata e Apelit ka zbutur llojin e masës së sigurimit në bazë të nenit 86 të K.Dr.P.M.

-Në lidhje me vepra penale të kryer personat juridikë, në zbatim të ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 “*Për pergjegjësinë penale të personave juridikë*” është gjykuar vetëm një çështje themeli, për veprën penale të “*Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike*” parashikuar nga neni 137/2 i K.Penal, të ardhur mbi apelin e prokurorit kundër vendimit për pafajësi. Mbi kërkimin e prokurorit të apelit për rëndim pozite (*për fajësi*), Gjykata e Apelit ka pranuar apelin duke disponuar për ndryshimin e

vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka deklaruar fajtor personin juridik për veprën penale objekt akuze.

-Në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (dekriminalizimi), është gjykuar vetëm një rast në ngarkim të të pandehurit V.Gj akuzuar për veprën penale “Falsifikimi i vulave, stampave ose formulareve” parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal. Çështja ka ardhur mbi ankimin e të pandehurit pasi ka rivendosur në afat të drejtën e ankimit, ku mbi kërkimin e prokurorit për lënie në fuqi të vendimit, Gjykata e Apelit ka disponuar me prishje dhe pushimin e çështjes. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs për zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe material penal, sipas standarit të ndjekur nga Prokuroria e Apelit Korçë në zbatim të ligjit nr.138/2015.

- Në zbatim të planit të veprimit të marrëveshjes me EUROJUST, në vazhdimësi janë marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe sigurimin e kushteve teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale. Prokuroria e Apelit Korçë ka krijuar “Rregullore” për përcaktimin e rregullave për aktet administrative dhe qarkullimi i tyre në institucion. Stafi i prokurorisë zbaton me korrektësi rregulloren e brëndshme, po ashtu dhe Raportin Monitorues të Komisionerit “Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të Dhënave Personale”, rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Prokurori”, miratuar me Urdhërin nr.140, datë 03.09.2019, të Prokurorit të Përgjithshëm, Ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Ligjin nr. 113/2018 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”.
- Ne Prokurorinë e Apelit Korçë, gjate vitit 2019 janë përmbushur të gjitha shpenzimet e paracaktuara në projekt-buxhetin e vitit 2019, që përfshijnë zërat: paga, sigurime shoqërore dhe shpenzimet operative. Korrektësia dhe disiplina financiare kanë qënë në nivel shumë të lartë në mënyrën e administrimit sa më eficient të shpenzimeve. Konstatohet bashkëpunim efektiv me Drejtorinë Ekonomike pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Disiplina në punë shihet si një element që ndikon në veprimtarinë e Prokurorisë së Apelit Korçë, e cila respektohet nga të gjithë punonjësit. Po kështu, Kodi i Etikës dhe rregullat e vendosura prej tij, janë në vëmendje të prokuroreve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë dhe respektohen maksimalisht.
- Prokuroria e Apelit Korçë me juridiksion të përgjithshëm ka një bashkëpunim korrekt dhe ligjor me institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme, duke informuar në mënyrë periodike për zbatimin e rekomandimeve në mbështetje edhe të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm për luftën kundër kriminalitetit.
- Gjithashtu është forcuar bashkëpunimi me Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Korçë / Pogradec, me juridiksion të përgjithshëm si një faktor i domosdoshëm për një zgjidhje të drejtë dhe ligjore të çështjes në Gjykatën e Apelit. Kjo kushtëzon një komunikim permanent në marrjen e akteve të ndryshme, fashikullit të prokurorit, marrjen e provave shtesë kur përsëritet shqyrtimi gjyqësor, apo edhe për fazën e ekzekutimit. Në çdo moment, Prokuroria e Apelit Korçë vë në dijeni Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës

së Parë (*prokurorin e çështjes*) për mënyrën e përfundimit të çështjeve, sidomos ato të ndjekura mbi apelin e prokurorit.

- Mbarëvajtja e veprimtarisë së Prokurorisë së Apelit Korçë lidhet me një bashkëpunim korrekt dhe në zbatim të ligjit me Gjykatën e Apelit, me strukturat e Policisë së Shtetit dhe Policisë Gjyqësore, me I.E.V.P-Korçë dhe Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, për fazën e ekzekutimit të vendimeve, si dhe me institucione të tjera ligjzbatuese, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore të Prokurorisë së Apelit.
- Për vitin 2020 shihet si objektiv kryesor rritja e nivelit të përfaqësimit të akuzës në apel dhe ndjekja me përparësi e çështjeve në luftën kundër kriminalitetit, në zbatim të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj, si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Duke ju falenderuar!

DREJTUESE E PROKURORISË

ROZETA QIRJAQI

